



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës, nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **7,840.00€**, (shtatë mijë e tetëqind e katërdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-27960 të datës 01.06.2023, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 28 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin maj të vitit 2023 me nga 280 euro për secilin rast $28 \times 280 = 7,840.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB .

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame e Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-27960
Lipjan, më 02.06.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të (klubet sportive) Nr.5-453/01-27858 të datës 31.05.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ - TË (KLUBET SPORTIVE) PËR
VITIN 2023

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **6,900.00 €** (gjashtë mijë e nëntëqind euro), për t'i mbështetur financiarisht OJQ-të (klubet sportive) të Komunës së Lipjanit për zhvillimin e aktiviteteve të tyre për vitin 2023, të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-15008 të datës 24.03.2023, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sportë.

2. Në tabelën vijuese janë OJQ-të (klubet sportive) përfituese të cilat do të mbështeten financiarisht nga Komuna për vitin 2023:

Nr.	Emërtimi i OJQ-ve (klubet sportive)	Shuma
1.	Shoqata e Pedagogëve të sportit shkollor	1,500.00 €
2.	Klubi Basketbollit "Lipjani"	3,000.00 €
3.	Klubi i Shahut "Ulpiana"	1,200.00 €
4.	Klubi i Shahut "Ced Elita"	1,200.00 €
	Shuma Totale	6,900.00 €

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2023 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe klubeve sportive do të rregullohen në Kontratat të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe secilit klub veq e veq.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.453/01-27858/2
Lipjan, më 22.06.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-28795 e datës 06.06.2023, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E
KËRKESAVE TË FERMERËVE

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve konform shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-28795 e datës 06.06.2023 për ndarjen e shpërndarseve plehu mineral, spërkatëse 400L për vitin 2023, (në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Fatbardha Shurdhiqi, Drejtorati për Infrastruktur, Kryesuese
2. Azem Arifi, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, anëtar
3. Merita Zeqiri Magashi, Drejtorati për Infrastruktur, anëtare

Neni 2
Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- Bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve për fermerë përkatësisht për shpërndarse plehu mineral, spërkatëse 400L për vitin 2023 sipas shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-28795 e datës 06.06.2023, brenda afatit prej 30 ditë pune pas pranimit të këtij Vendimi në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-28795 e datës 06.06.2023 dhe legjislacionit në fuqi.
- I rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve.

- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
- Rekomandimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave publikon listën preliminare të përfituesve ku palët e pakënaqura kanë drejtë ankese në Komisionin e ankesave brenda afatit 15 ditor nga dita e publikimit të listës.
- Pas përfundimit të procedurave të ankesave, Komisioni vlerësues shpallë listën finale nëse ka ndryshime nga ajo preliminare varësisht nga Vendimi i Komisionit të ankesave.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, kryesuesi dhe anëtarët e komisionit.

1Nr. 020/04-32148
Lipjan, 21.06.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE -SUBVENCIONIM NË ZYRËN LOKALE PËR KOMUNITETE

Neni 1

Formimi i Komisionit dhe përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje financiare subvencionim të cilat i parashtrohen Zyrës Lokale për Komunitete, në këtë përbërje:

1. Zoran Stojaneviq, kryesues - Zyra e Lokale për Komunitete
2. Gradimir Zarkovic, anëtar - Zyra e Lokale për Komunitete
3. Fatmir Goliqi, anëtar - Zyra e Lokale për Komunitet

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe mandati Komisionit

- Bën shqyrtimin e kërkesave të parashtuara për mbështetje financiare - subvencionim të cilat i parashtrohen Zyrës Lokale për Komunitete dhe sipas nevojës del në teren me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike .
- Komisioni mban procesverbal për rastet e verifikuara në teren.
- Mandati i komisionit është tre vjeçar.
- Pas shqyrtimit të kërkesave Komisioni i rekomandon Kryetarit të Komunës marrjen e vendimeve lidhur me ankesat e aprovura nga Komisioni.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr.020/04-28784

Lipjan, më 07.06.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 90 të Ligjit Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA VËRSHIMET NË EKONOMIT FAMILJARE NË KOMUNEN E LIPJANIT

I. Formohet Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e ditëve të fundit, të cilat kanë ndodhur si pasojë e të reshurave dhe motit të lig në territorin e Komunës së Lipjanit në ekonomit familjare, në këtë përbërje:

1. Xhelil Murati, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryesues
2. Enver Elshani, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar dhe
3. Bedri Hetemi, Drejtorati për Inspektorat, anëtar

II. Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera do ti kryej detyrat si në vijim:

- Të bëjë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në ekonomit familjare,
- Të hartoj procesverbal për secilin rast të evidentuar duke i bashkëngjitur edhe fotot.

III. Komisioni pas kryerjes së detyrave të cekura në pikën II duhet të hartoj raport me shkrim të cilin do ti a dërgoj Kryetarit të Komunës dhe Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim. Raportit i bashkëngjitet procesverbali me foto për secilin rast veq e veq.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-30337
Lipjan, më 13.06.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 90 të Ligjit Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA VËRSHIMET NË INFRASTRUKUREN E KOMUNES SË LIPJANIT

I. Formohet Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e ditëve të fundit, të cilat kanë ndodhur si pasojë e të reshurave dhe motit të lig në territorin e Komunës së Lipjanit, në fushën e infrastruktures, në këtë përbërje:

1. Labinot Dedushi, Drejtorati për Infrastruktur, Kryesues
2. Valzim Mziu, Drejtorati për Infrastruktur, anëtar dhe
3. Behar Mjeku, Drejtorati për Inspektorat, anëtar

II. Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera do ti kryej detyrat si në vijim:

- Të bëjë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturën fizike,
- Të hartoj procesverbal për secilin rast të evidentuar duke i bashkëngjitur edhe fotot.

III. Komisioni pas kryerjes së detyrave të cekura në pikën II duhet të hartoj raport me shkrim të cilin do ti a dërgoj Kryetarit të Komunës dhe Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim. Raportit i bashkëngjitet procesverbali me foto për secilin rast veq e veq.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-30339
Lipjan, më 13.06.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 90 të Ligjit Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA VËRSHIMET NË FUSHËN E BUJQËSISË NË KOMUNEN E LIPJANIT

I. Formohet Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e ditëve të fundit, të cilat kanë ndodhur si pasojë e të reshurave dhe motit të lig në territorin e Komunës së Lipjanit në fushën e bujqësisë, në këtë përbërje:

1. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqesi dhe Pylltari, Kryesues
2. Sadete Maholli, Drejtorati për Bujqesi dhe Pylltari, anëtare dhe
3. Avni Sahiti, Drejtorati për Inspektorat, anëtar

II. Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/-L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera do ti kryej detyrat si në vijim:

- Të bëjë vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në fushën e bujqësisë,
- Të hartoj procesverbal për secilin rast të evidentuar duke i bashkëngjitur edhe fotot.

III. Komisioni pas kryerjes së detyrave të cekura në pikën II duhet të hartoj raport me shkrim të cilin do ti a dërgoj Kryetarit të Komunës dhe Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim. Raportit i bashkëngjitet procesverbali me foto për secilin rast veq e veq.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-30335
Lipjan, më 13.06.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në Komunën e Lipjanit që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Nr.5-453/01-29036 të datës 06.06.2023, në përbërje si vijon:

1. Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Blerta Bytyqi nga OJQ-të, anëtare
5. Majlinda Krasniqi, nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertes, anëtare
6. Saranda Krasniqi, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare rezerv

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve në projektet për avancimin dhe afirmimin e kulturës dhe sportit duke përfshirë organizimin e festivalit "Mërgata Fest 2023" në Komunën e Lipjanit konform Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-29036 të datës 06.06.2023, të shpallur nga Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Komisioni do t'i kryen detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kultur, Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-31710
Lipjan, më 20.06.23

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Rregullores MF - Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në kërkesën e DKA –së Nr.1-020/04-30189 të datës 13.06.2023, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1 Përbërja e Komisionit

Formohet komisioni për përcaktimin e çmimit fillestar për shitjen e prodhimeve bimore të grurit në përbërje si vijon:

1. Ismet Haziri, Drejtorati për Arsim, Kryesues,
2. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar dhe
3. Arben Bahtiri, Drejtorati për Arsim, anëtar

Neni 2 Detyrat e Komisionit

1. Detyrë e Komisionit është që të përcaktojë çmimin fillestar për shitjen e grurit në parcelat në pronësi të shkollës "Adem Gllavica" në Lipjan, duke u bazuar në Kërkesën e DKA-së Nr.1-020/04-30189 të datës 13.06.2023.
2. Komisioni detyrën e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi do ta kryejë më së largu brenda afatit 8 ditor nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Neni 3 Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë ndërsa me kopjen e këtij Vendimi do të njoftohen Drejtorati për Arsim, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr.020/04-30189
Lipjan, më 14.06.2023

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, nenit 4 të Udhëzimit administrativ nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit publik si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

**VENDIM
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT TË AUDITIMIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT**

Neni 1

Themelimi ,përbërja dhe mandati i Komitetit të Auditimit

Me këtë Vendim, themelohet Komiteti i Auditimit në Komunën e Lipjanit (në vazhdim të tekstit Komiteti), në përbërje si vijon:

1. Fitim Sadiku, nga shoqëria civile, Kryesues,
2. Fatbardha Shurdhiqi, nëpunëse civile, anëtare,
3. Shkëlqim Bahtiri nga shoqëria civile, anëtar

Mandati i Komitetit është 3 (tre) vjeçar.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe takimet e Komitetit

1. Komiteti do të kryej detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me dispozitat të Ligjit Nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe Udhëzimit administrativ nr.01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit publik.
2. Takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër (4) herë në vit dhe ftohen nga Kryesuesi i Komitetit të Auditimit
3. Udhëheqësi i njësisë së auditimit të brendshëm merr pjesë në takimet e Komitetit të Auditimit me përjashtim kur Komiteti i Auditimit diskuton temat që ndërlidhen me performancën e Njësisë së auditimit të brendshëm të subjektit të sektorit publik.
- 4.Njësia e auditimit të brendshëm ofron shërbimet e sekretarisë për Komitetin e Auditimit
- 5.Pagesa e anëtarëve të Komitetit bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Njësia e Auditimit të brendshëm, Kryesuesi dhe anëtarët e Komitetit .

1Nr. 020/04-30942
Lipjan, më 15.06.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, konform edhe dispozitave të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Z. Imri Ahmeti dhe OJQ-së Ndërkombëtare Caritasit Switzerland (në Kosovë) me përfaqësues ligjor Z. Gerhard Schaumberger 1Nr-660/03-6458 të datës 06.02.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM
PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE**

Neni 1

Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve në vlerë prej **440.00 €** (katërqind e katërdhjetë euro për zbatimin e obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e nenit 4 të Marrëveshjes për Bashkëpunim të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit përfaqësuar nga Z. Imri Ahmeti dhe OJQ-së Ndërkombëtare Caritasit Switzerland (në Kosovë) me përfaqësues ligjor Z. Gerhard Schaumberger 1Nr-660/03-6458 të datës 06.02.2023. me titull të Projektit : Ndikimi i Rinisë në Mjedis –YENI (P220002).

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga kategoria ekonomike –mallra dhe shërbime të Drejtoratit për Arsim në xhirollogarinë bankare :

Banka: Raiffeisen Bank

Emri: CARITAS SWITZERLAND

IBAN: XK051502001000368642

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Arsim.

1Nr. 400/01-32319
Lipjan, më 22.06.2023

KRYETARI I KOMUNES
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, , neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 , Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndarjen e mjeteve financiare Nr.15-400/01-22359 të datës 28.04.2023 si dhe Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit 1-400/01-23123 të datës 10.05.2022 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" , Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 24.11.2022 dhe Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 13.04.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE FINANCIARE

Neni 1

1.Me këtë Vendim, **TRANSFEROHET**, shuma e mjeteve më vlerë prej **29.918.00 €** (njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë euro konform Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit 1-400/01-23123 të datës 10.05.2022 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" , Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 24.11.2022 dhe Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 13.04.2023, me qëllim të përkrahjes familjeve me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Lipjanit për sigurimin e serrave bujqësore, mekanizëm bujqësorë dhe në fushën e blegtorisë duke u bazuar edhe në Raportet e Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari të datës 13.06.2023 me nr. 6-400/01-29996 dhe 6-400/01-30002.

2.Shuma totale cekur në paragrafin 1 të këtij neni do të ekzekutohet në dy pjesë përkatësisht :

- a. 23,332,00 euro (njëzet e tremijë e treqind e tridhjetë e dy euro) me destinim për subvencionimin –e familjeve me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Lipjanit me serra bujqësore si dhe
- b. 6,586.00 euro (gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë euro) me destinim për subvencionimin –e familjeve me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Lipjanit

me mekanizëm bujqësor (frezë për traktor, kosë për traktorë) si dhe në fushën e blegtorisë (lope qumështore dhe kope delesh).

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2023, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për vitin 2023 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari në xhironlogarinë bankare të Organizatës "Qatar Charity" Nr. 1701001600054596 në NLB Banka.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë ndërsa për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.

1Nr. 400/01-31157
Lipjan, më 16.06.2023

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

